

RAPORT VJETOR
PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE-OPERATIVE (ATO)
PËR VITIN 2024

Shkup,
shkurt, 2025

PËRMBAJTJA:

PËRMBAJTJA	2
SHKURTESAT E PËRDORURA.	2
I. HYRJE.....	3
II. LEGJISLACIONI DHE KOMPETENCAT	4
III. AKTIVITETET DHE REZULTATET E PUNËS NË PERIUDHËN E RAPORTIT.....	4
IV. ORGANIZIMI I PUNËS.....	8
V. PUNA FINANCIARE E ATO-s NË VITIN 2024	9
VI. BASHKËPUNIMI.....	13
VII. PUBLIKIMI.....	15

SHKURTESAT E PËRDORURA

ATO	Agjencia Teknike-Operative
DSIK	Drejtoria për Sigurinë e Informatave të Klasifikuara
AKE	Agjencia për Komunikime Elektronike
LATO	Ligji për Agjencinë Teknike-Operative
LNK	Ligji për ndjekjen e komunikimeve
LPP	Ligji për procedurën penale
LKE	Ligji për komunikimet elektronike
LMDHP	Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale
LIK	Ligji për Informatat e klasifikuara
SKI	Sistemi komunikues-informativ
MPH	Masat e posaçme hetimore

I. HYRJE

Në pajtim me nenin 7 të Ligjit për Agjencinë teknike-operative (LATO) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 71/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 98/19), drejtori i ATO dorëzon për shqyrtim deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Verit raport vjetor për punën e ATO për vitin e kaluar kalendarik, më së voni deri në fund të shkurtit të vitit vijues.

Në aspekt të plotësimit të obligimit ligjor, në afatin e paraparë është përgatitur dhe dorëzuar për shqyrtim ky Raport vjetor për punën e ATO për periudhën raportuese nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2024. Krahas përpikshmërisë për plotësimin e detyrës ligjore, qëllimi i këtij Raporti vjetor është informimi në kohë, transparent dhe llogaridhënës i autoriteteve kompetente dhe publikut për gjendjet, aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura nga ana e ATO në periudhën raportuese.

Ky Raport vjetor për punën e ATO përmban të dhëna precize të mbledhura dhe përpunuara nga njësi të ndryshme organizative në kuadër të ATO gjatë tërë periudhës raportuese, e që kanë të bëjnë me elementet e detyrueshme ligjore që duhet t'i përmbaj raportit vjetor i theksuar në nenin 7 paragrafi 3 i LATO sic janë të dhënat për: numrin e komunikimeve të aktivizuara për nevojat e organeve të autorizuara; numrin e komunikimeve të aktivizuara për secilin organ të autorizuar veçmas, gjendja dhe konstatimet gjatë mbikëqyrjet e realizuara profesionale nga ana e ATO mbi punën e operatorëve, numrit të procedurave të zbatuara disiplinore ndaj nëpunësve në ATO; punën financiare të ATO.

Krahas këtyre elementeve të detyrueshme ligjore, si një hap proaktiv drejt informimit më të detajuar, ky dokument përmban edhe informata plotësuese objektive dhe të besueshme dhe të dhëna për të krijuar një përshtypje reale për organizimin e përgjithshëm dhe rezultatet e punës së ATO, si dhe për rrjedhat dhe gjendjet e rëndësishme në punën e ATO gjatë periudhës raportuese.

II. LEGJISLACIONI DHE KOMPETENCAT

ATO është themeluar me LATO si organ shtetëror i pavarur dhe i më vetëm. Me ligjin rregullohen themelimi, kompetencat, udhëheqja, të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës të nëpunësve në ATO, mbikëqyrja profesionale dhe financimi i ATO. Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, ATO është e obliguar që me shpenzime vetjake të sigurojë dhe mirëmbajë pajisjen dhe aparatet Mediatike me qëllim të krijimit dhe aktivimit të kushteve teknike për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve, në pajtim me ligjin. ATO vepron si organ ndërmjetësues që siguron lidhje dhe kalim teknik ndërmjet operatorëve dhe organeve të autorizuara me qëllim të zbatimit të ndjekjes së komunikimeve, vetëm në bazë të urdhëresës gjyqësore, si dhe nevojave për hetimet penale, ashtu edhe për mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit, në pajtim me Ligjin për procedurë penale dhe Ligjin për ndjekjen e komunikimeve dhe pa pasur qasje në përmbajtjen e komunikimit të ndjekur. Së këndejmë, ATO krijon masa dhe procese për shmangien e sulmeve dhe keqpërdorimeve të brendshme dhe të jashtme kompjuterike. Si pjesë e kompetencave ligjore, ATO realizon edhe mbikëqyrje profesionale ndaj punës së operatorëve, për çka drejtori i ATO formon komision nga radhët e nëpunësve në ATO për mbikëqyrje profesionale ndaj operatorëve.

Për kompetencat dhe procedurën e realizimit të punës dhe obligimeve nga fushëveprimi i punës së ATO, krahas me LATO, janë relevante edhe Ligji për procedurë penale (LPP) dhe Ligji për ndjekjen e komunikimeve (LNK), Ligjin për komunikime elektronike (LKE), Ligjin për informata të klasifikuara (LIK),

Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (LMDHP), si dhe rregullore të tjera pozitive-juridike relevante për sferat adekuate.

III. AKTIVITETET DHE REZULTATET E PUNËS NË PERIUdhËN RAPORTUESE

Numri i komunikimeve të aktivizuara për nevojat e organeve të autorizuara

Gjatë vitit 2023, ATO teknikisht ndërmjetësonte për aktivimin e gjithsejtë 257 komunikimeve për nevojat e organeve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me metodologji, si numër i komunikimeve të aktivizuara për nevojat e organeve të autorizuara është prezantuar numri i të gjitha komunikimeve që janë aktivuar në bazë të urdhëresave të pranuar gjyqësore në ATO për zbatimin e masave për ndjekjen dhe incizimin e komunikimeve elektronike dhe jo vetëm, gjatë vitit raportues, respektivisht në periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2024. Së këndejmë, me këto masa për ndjekjen dhe incizimin e komunikimeve telefonike dhe të tjera elektronike nënkuptohen masat e vecanta hetuese dhe masat për ndjekjen e komunikimeve për mbrojtjen e interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit. Me komunikim të aktivizuar nënkuptohet secili komunikim i ri që është aktivizuar me një parametër të vetëm të papërsëritshëm të numrit identifikues të shënuar në urdhëresën gjyqësore.

Numri i komunikimeve të aktivizuara për secilin organ veçmas.

Në periudhën raportuese nga 01.01.2024 e deri më 31.12.2024 me ndërmjetësimi teknik te ATO u aktivizuan:

- 195 komunikime për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- 9 komunikime për nevojat e Drejtorisë së Policisë Financiare dhe
- 1 komunikim për nevojat e Prokurorisë Publike Themelore për përndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Metodologjikisht, ky seksion tregon numrin e komunikimeve të aktivizuara për secilin organ të autorizuar veç e veç. Në të njëjtën kohë, në përputhje me nenin 7 paragrafi 3 paragrafi 2 të LATO, nuk është deklaruar numri i komunikimeve të aktivizuara për nevojat e sigurisë dhe mbrojtjes

Gjendja dhe konstatimet gjatë mbikëqyrjeve profesionale nga ana e ATO ndaj punës së operatorëve

Një prej karakteristikave të sektorit të telekomunikimit është progresi dhe zhvillimi i vazhdueshëm dhe i shpejtë teknologjik, të cilin operatorit e telekomunikimit e ndjekin përmes modernizimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve ekzistuese dhe futjes së teknologjive dhe zgjidhjeve të reja gjatë sigurimit të shërbimeve të të dhënave ndaj shfrytëzuesve të fundit.

Të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me infrastrukturën, përplotësimet softuerike, rrjetin dhe elementet e rrjetit dhe/ose konfigurimin e tyre, e që tërheqin investime dhe/ose rikonfigurimin e pajisjeve LEIMD dhe LEMF dhe/ose kontrollit të funksionaliteteve LI, operatorët e telekomunikimit janë të detyruar që t'ia paraqesin në kohë ATO-s. Në atë kuptim, pas njoftimeve nga operatorët e telekomunikimit, ekipet e ATO-s dhe operatorët janë në komunikim të rregullt dhe të vazhdueshëm dhe ndërmarrin aktivitete të koordinuara me qëllim të analizës dhe kontrollit sistematik të gjendjeve, mjedisit të nevojshëm dhe përmbushjes së kushteve të infrastrukturës së operatorëve lidhur me implementimin e zgjidhjeve dhe përmbushjen e funksionalitetit për ndjekje ligjore të komunikimeve elektronike (LI), me qëllim mundësimin e kushteve të nevojshme teknike për aktivizim të masave për ndjekje dhe incizim të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike me ndërmjetësim të ATO-s dhe operatorëve.

Krahas aktiviteteve të rregullta dhe rrjedhëse, në tremujorin e fundit të periudhës së raportit, nga Komisioni për kryerje të mbikëqyrjes profesionale të operatorëve të ATO-s u bënë njoftime dhe aktivitete për fillimin e kryerjes së mbikëqyrjeve profesionale të operatorët e telekomunikimit Telekom i Maqedonisë, A1 Makedonia, MTel, Telekabel dhe Neotell, që janë në rrjedha dhe vazhdojnë edhe në vitin kalendarik 2025.

Lëndë e mbikëqyrjes është kontrolli i harmonizimit/përmbushjes së kërkesave administrative, organizative dhe teknike, përkatësisht kontroll të mbikëqyrjes së përdorimit të pajisjes teknike dhe përçuesve të komunikimit elektronik që shërbejnë për lidhje të ATO-s dhe operatorëve, kontroll të dokumentacionit dhe në aktivitetet që ndërmerren për zbatim të masave dhe standardeve për siguri informuese, për mbrojtje të të dhënave personale dhe mbrojtje të informatave të klasifikuara.

Akreditimi i sistemit informativ komunikues (SIK) për menaxhimin e informatave të klasifikuara nacionale

Nga ana e ATO-s është vendosur sistem i akredituar komunikues-informativ (SKI) për administrimin e informacioneve të klasifikuara nacionale të harmonizuara me rregullativat nacionale dhe me standardet bashkëkohore teknike-teknologjike dhe të NATO-s, që siguron një lidhshmëri ligjore, të mbrojtur, të sigurt, të shpejtë dhe efikase digjitale, komunikim dhe interoperabilitet ndërmjet organeve të autorizuar dhe kompetente në procesin për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve.

Drejtoria për siguri të informacioneve të klasifikuara (DSIK) në vitin 2023 ATO-s i lëshoi certifikatë për akreditim të SKI-së, sipas së cilës sistemi i vendosur në pronësi të ATO-s, në lokacionet e cekura i përmbush kushtet për krijimin, ruajtjen, përpunimin ose bartjen e informacioneve të klasifikuara nacionale në formë elektronike me shkallë “Tepër sekret”.

Në periudhën e raportit, vazhduan aktivitetet e zgjerimit të përfaqësimit territorial të SKI-së së vendosur, përkatësisht implementimi i tij në shet në nivel të rajoneve të apelit dhe gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar.

Gjatë vitit 2024, me kërkesë të ATO-s u realizuan aktivitete për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës për akreditim të lëshuar nga DSIK të këtij sistemi komunikues-informues.

Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të sigurisë në lokacionet konkrete, në vitin 2024, akreditimi i sistemit komunikues-informues u vërtetua dhe u vazhdua me Vendim të miratuar nga Drejtoria e Sigurisë së Informatave të Klasifikuara.

Prezantimi, organizimi dhe realizimi i trajnimeve për organet kompetente dhe të autorizuar nga ana e ATO

Struktura, funksioni dhe mundësitë e sistemit komunikues-informues (SKI) për administrimin e informatave të klasifikuara të vendosura nga ATO, në tetor 2024 u prezantuan para ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtorit të Byrosë së Sigurimit Publik, në prezencë të Prokurorit publik themelor Shkup dhe Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë muajit tetor 2024, ATO organizoi dhe realizoi trajnim të përfaqësuesve të përkushtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për përdorimin e sistemit për punë me informacione të klasifikuara nacionale, përkatësisht sistemit për digjitalizim të procesit të zbatimit të masës për ndjekje të komunikimeve elektronike, me ç'rast u trajnuan rreth 50 përdorues të sistemit, përkatësisht pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të lëshimit dhe përcjelljes së urdhrave gjyqësore të masës së veçantë hetuese për ndjekje të komunikimeve elektronike.

Mbikëqyrja dhe kontrolli

Kontrolli i ligjshmërisë së zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve, të organeve të autorizuar, operatorët dhe ATO kryejnë: prokurori publik i cili e udhëheq hetimin dhe gjyqi në procedurë paraprake i cili e ka lëshuar urdhrin për masë të veçantë hetuese në pajtim me ligjin, përkatësisht Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjyqi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut që e ka lëshuar urdhrin për ndjekje të komunikimeve.

Mbikëqyrjen mbi masat për monitorimin e komunikimeve të zbatuara nga autoritetet e autorizuar, si dhe mbikëqyrjen mbi operatorët dhe ATO-të e bëjnë: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Drejtoria për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, Agjencia për Mbrojtja e të dhënave personale dhe Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë, si dhe Këshilli për kontroll civil.

Gjatë periudhës raportuese, në bazë të nenit 57 paragrafi (2) nënparagrafi 1 dhe neni 59 të Ligjit për ndjekje të komunikimeve ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 71/2018, dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 108/2019 dhe 154/2023) në ATO u krye kontroll të ligjshmërisë së zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes së interesave të sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit nga neni 18 paragrafi 1 të LPK, me ç'rast nuk u konstatuan vërejtje dhe u konstatua veprim ligjor.

IV. ORGANIZIMI I PUNËS

Organizimi i punës

Në fund të periudhës raportuese, ATO-ja numroi 22 punonjës dhe 1 funksionar, person i zgjedhur dhe i emëruar – drejtor i ATO-së. Në përputhje me LATO-në (neni 35 paragrafi (1)) me qëllim të themelimit dhe vendosjes së ATO-së, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut siguroi pronë të tundshme dhe të patundshme, me ç'rast për realizimin e punëve në kompetencën e vet, ATO-ja shfrytëzoi hapësirat me qira.

Të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës, punonjësit në ATO i realizojnë në përputhje me dispozitat e LATO-së, rregullat në fushën e marrëdhënieve të punës dhe marrëveshjes kolektive. Në përputhje me LATO-në, punonjësit në ATO kanë statusin e personave të autorizuar zyrtarë, për punësimin e të cilëve, përveç kushteve të tjera të përgjithshme, domosdoshmërisht është e nevojshme që me kontrollin e sigurisë të konstatohet se nuk ekziston rrezik i sigurisë nga punësimi i personit, si dhe posedimi i certifikatave kombëtare të sigurisë të shkallës së lartë, si kusht i veçantë. Si organ i pavarur dhe i mëvetësishëm shtetëror, i themeluar në vitin 2018, duke i vendosur të gjitha kapacitetet e veta që nga fillimi duke e përfshirë edhe personalin njerëzor, për shkak të realizimit të funksionalitetit të vet institucional, si dhe për shkak të largimit të kuadrit, në periudhën në vijim ATO-ja ka nevojë dhe fokus për ekipimin me kuadër profesional.

Numri i zbatimit të procedurave disiplinore për punonjës në ATO në vitin 2024

Gjatë vitit 2024 në ATO nuk ishin zbatuar procedura disiplinore për punonjës në ATO.

IV. PUNA FINANCIARE NË ATO GJATË VITIT 2024

Mënyra e financimit të ATO-së është rregulluar me nenin 33 të LATO-së dhe nenin 29-a të LKE-së.

Mjetet për pagë, kompensime dhe shtesa tjera në pagë, për punë, avancime, modernizime dhe pajisje në ATO, si dhe për stimulimin e punonjësve në ATO, të parapara me Planin Financiar Vjetor të ATO-së, sigurohen:

- nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (a.q. shpenzime nga buxheti themelor) dhe
- nga kompensimet e Agjencisë për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me nenin 29-a të LKE-së, në bazë të Planit Financiar Vjetor të miratuar paraprakisht të ATO-së nga Komisioni për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (a.q. shpenzime nga aktivitetet vetëfinancuese). Në përputhje me LKE-në, AKE-ja është e detyruar që shumat e parapara të përcaktuara në Raportin Vjetor të Punës së AKE-së për vitin e kaluar kalendarik të miratuar nga Komisioni i AKE-së, t'ia paguaj ATO-së më së voni deri më 15 prill të vitit vijues.

Buxheti i Agjencisë Teknike Operative për vitin 2024

Gjatë vitit buxhetor 2024 në aspekt të sigurimit të mjeteve në Buxhetin e ATO-së janë miratuar aktet relevante si në vijim:

1. *Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 283/2023);*
2. *Ndryshimi dhe plotësimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 169/2024);*
3. *Vendimi për rishpërndarjen e mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 250/2024).*

Pasqyra e miratimit, ndryshimeve dhe plotësimeve të Buxhetit të ATO-së gjatë vitit 2024 është paraqitur në Tabelën 1.

Struktura e Buxhetit të përgjithshëm final për vitin 2024 sipas llogarive është paraqitur në Grafikon 1.

Tabela 1. Buxheti i Agjencisë Teknike Operative për vitin 2024


STRUKTURA E BUXHETIT	LLOGARIA	BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2024 ¹	NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ²	VENDIMI PËR RISHPËRNDARJEN E MJETEVE NDËRMJET SHFRYTËZUESVE BUXHETORË DHE PUSHTETIT QENDROR DHE NDËRMJET FONDEVE ³	BUXHETI FINAL I ATO-SË PËR VITIN 2024
		a	b	v	r=b+v
SHPENZIMET E BUXHETIT THEMELOR	630	231.841.000,00	91.342.000,00	-431.000,00	90.911.000,00
SHPENZIMET NGA AKTIVITETET VETËFINANCUESE	787	90.000.000,00	119.000.000,00	0.00	119.000.000,00
GJITHSEJ SHPENZIME		321.841.000,00	210.342.000,00	-431.000,00	209.911.000,00

Grafiku 1. Struktura e Buxhetit final të ATO-së për vitin 2024 sipas llogarive

¹ Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 283/2023

² Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 169/2024

³ Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 250/2024



Shpenzimet e Buxhetit Themelor

Shpenzimet e Buxhetit Themelor gjatë vitit 2024 ishin zvogëluar për shumën e përgjithshme prej 140.930.000,00 denarë.

Shpenzimet nga aktivitetet vetëfinancuese

Projektimet për realizimin e shpenzimeve nga aktivitetet vetëfinancuese në vitin 2024 janë planifikuar me Planin Financiar Vjetor për vitin 2024 të ATO-së, të cilat ishin miratuar nga Komisioni për Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masave për Ndjekjen e Komunikimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpenzimet e planifikuara nga aktivitetet vetëfinancuese gjatë vitit 2024 në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ishin rritur për shumën e përgjithshme prej 29.000.000,00 denarë.

Realizimi i Buxhetit të Agjencisë Teknike Operative për vitin 2024

Nga mjetet e përgjithshme të miratuara në shumën prej 209.911.000,00 në Buxhetin e ATO-së për vitin 2024, deri në fund të vitit 2024 ishin realizuar mjete në shumën e përgjithshme prej 117.022.960.00 denarë, me ç'rast realizimi i Buxhetit sipas llogarive është si në vijim:


- nga shpenzimet e Buxhetit Themelor në vitin 2024 u realizuan gjithsej 86.632.458,00 denarë,
- nga shpenzimet nga aktivitetet vetëfinancuese, në vitin 2024 janë realizuar gjithsej 30.390.502,00 denarë. Pjesa e parealizuar e mjeteve në përputhje me Ligjin për buxhetet në fund të vitit fiskal transferohet në vitin e ardhshëm 2025.

Realizimi i mjeteve të planifikuara të Buxhetit të ATO-së për vitin 2024, sipas zërave është paraqitur në Tabelën 2, ndërsa struktura e realizimit procentual sipas zërave është paraqitur në Grafikon 2 më poshtë.

Tabela 2. Realizimi sipas zërave të Buxhetit të ATO-së për vitin 2024

Zëri	Nënzëri	Shumat e realizuara në denarë
40 – Paga dhe kompensime	401	27.918.622,00
	402	13.286.581,00
	404	285.584,00
42 – Mallra dhe shërbime	420	45.960,00
	421	2.630.030,00
	423	382.937,00
	424	46.203.320,00
	425	10.813.843,00
	426	314.937,00
46 – Subvencione dhe transfere	464	123.255,00
48 – Shpenzime kapitale	480	11.662.281,00
	481	0.00
	483	48.000,00
	485	3.307.610,00
	486	0.00
GJITHSEJ		117.022.960,00

Grafiku 2. Realizimi i Buxhetit sipas zërave për vitin 2024



Nga të dhënat për realizimin mund të konstatohet se pjesa më e madhe e Buxhetit të përgjithshëm të ATO-së për vitin 2024, respektivisht 51,61% janë realizuar në zërin 42-Mallra dhe shërbime prej ku shuma më e madhe janë mjetet e shfrytëzuara për realizimin e kompetencës ligjore të ATO-së për mirëmbajtjen

e pajisjeve dhe aparateve të ndërmjetësimit për të krijuar kushte për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve.

V. BASHKËPUNIMI

Në periudhën raportuese, ATO-ja realizoi bashkëpunim të rregullt me institucionet, organet dhe trupat relevante, me qëllim të zbatimit konsekuent të rregullave pozitive dhe rregullativës sipas të cilave vepron.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, dhe në drejtim të koordinimit dhe shqyrtimit të nevojave për realizimin e kompetencave ligjore në fushëveprimin e përbashkët të punës, ishin realizuar takimet e punës ndërmjet udhëheqësive dhe punonjësve të ATO-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, Byrosë së Sigurisë Publike, Drejtorisë së Policisë Financiare, Drejtorisë së Doganave, Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe prokurorive publike dhe gjykatave.

Në tetor 2024 ishte nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Teknike Operative dhe Ministrisë së Transformimit Digjital. Me nënshkrimin e Memorandumit u konfirmua angazhimi i përbashkët i të dy institucioneve në drejtim të përmirësimit, avancimit dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht me angazhimet për avancimin e teknologjive të komunikimit dhe informatike (TKI), digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike.

Gjatë vitit raportues, përfaqësuesit e Agjencisë Teknike Operative morën pjesë drejtpërdrejt në përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2028, si dhe në procesin e konstatimit të standardeve kibernetike të sigurisë për institucionet shtetërore dhe rekomandimet për krijimin e politikave për forcimin e rezistencës kombëtare dhe sigurinë e infrastrukturës kritike.

Në dhjetor 2024, drejtoresha e ATO-së ishte e pranishme dhe mori pjesë aktive në kuadër të tryezës së rrumbullakët “Reformat e sistemit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut” të organizuar nga Fakulteti i Sigurisë Shkup pranë Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir, pas së cilës nga organizatorët ishin formuluar konkluzione dhe propozime që iu dorëzuan pjesëmarrësve dhe institucioneve të sigurisë në shtet.

Si pjesë e bashkëpunimit me DCAF – Qendrën e Gjenevës për Menaxhimin e Sektorit të Sigurisë, ndërsa për shkak të përmirësimit të sigurisë së shtetit dhe qytetarëve në kuadër të sundimit demokratik, sundimit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, ATO-ja vazhdimisht edhe në periudhën raportuese ishte e përfshirë dhe u ofroi mbështetje aktiviteteve të cilat në kuadër të Programit të Reformave në Sektorin e Zbulimit dhe të Sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026) janë organizuar nga DCAF. Më pas, gjatë vitit 2024, ATO-ja dha kontributin e vet nëpërmjet pjesëmarrjes me përfaqësuesit e vet dhe transferimin e njohurive, përvojave dhe praktikave në kuadër të më shumë segmenteve, përkatësisht:

- *Mbështetja e komunitetit të sigurisë dhe të zbulimit* – përfaqësuesit e ATO-së në janar 2024 ishin ligjërues në kuadër të kursit të parë për sigurinë ushtarake dhe zbulimin dhe qeverisjen e mirë, të organizuar nga DCAF dhe Shërbimi Ushtarak i Sigurisë dhe Zbulimit (VSBiR). Në kuadër të kursit, i cili përmbante tema të qeverisjes së mirë të sektorit të sigurisë me fokus në sigurinë ushtarake dhe zbulimin, ligjëruesit e ATO-së dhanë kontribut të rëndësishëm dhe pjesëmarrësve në kursin e nivelit të mesëm të

menaxhimit në VSBiR u transferuan njohuri, praktika dhe përvoja specifike në fushën e aplikimit dhe përdorimit të masave dhe sistemeve për ndjekjen e komunikimeve.

- *Udhërrëfyesi për asgjësimin e të dhënave të grumbulluara me masat e veçanta të hetimit* – ATO-ja përmes Ministrisë së Drejtësisë dorëzoi shqyrtime me shkrim, komente, vërejtje dhe shënime për versionin e punës së Udhërrëfyesit, në zhvillimin dhe përgatitjen e të cilit morën pjesë grupe ekspertësh dhe ato i prezantoi edhe në një pjesë të punëtorive të grupit të punës.

- *Tryeza e rrumbullakët për mbikëqyrjen parlamentare mbi sigurinë dhe zbulimin* - drejtoresha e ATO-së, në nëntor 2024 ishte e pranishme dhe mori pjesë aktive në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga DCAF.

Si pjesë e konkluzioneve që dalin nga puna dhe zbatimi i zgjidhjeve ligjore, si dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, është konstatuar nevoja e rregullimit shtesë të zbrazëtirave të caktuara juridike ose mosharmonizimeve përmes miratimit, ndryshimit dhe/ose plotësimit të akteve ligjore dhe nënligjore relevante, si dhe zhvillimit të politikave kombëtare përkatëse dhe rregullativës që do t'u përgjigjen nevojave të institucioneve të sektorit publik dhe të sigurisë për tërheqjen dhe mbajtjen e kuadrove të talentuara, të specializuara dhe të kualifikuara me kulturë të zhvilluar të sigurisë, veçanërisht në fushën e TKI-së.

VI. PUBLIKIMI

Ky Raport Vjetor i Punës së Agjencisë Teknike Operative (ATO) për vitin 2024, në afatin e paraparë ligjor, i dorëzohet për shqyrtim Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ai publikohet në vend publik në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut www.sobranie.mk dhe në faqen e internetit të ATO-së, www.ota.mk.

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

DREJTORESHË,

Marija Janiçeska

Punuar në 3 (tre) ekzemplarë origjinalë dhe i dorëzohet:

- Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1 ekzemplar
- Zyrës së Protokollimit të ATO-së, 2 ekzemplarë